



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2464/3 Prot.

Tiranë, më 05.10. 2023

V E N D I M

Nr. 104 dt. 05.10. 2023

“PËR

MBYLLJEN E PROJEKTIT SHKENCOR "65 VJET TRASHËGIMI E HISTORI E UST NË LENTEN E KËRKUESVE DHE STUDIUESVE MULTIDISCIPLINARE" FITUES ME VENDIMIN NR. 10, DATË 28.06.2022 TË KOMISIONIT TË KËRKIMIT PROJEKTEVE DHE BOTIMEVE SHKENCORE DHE HAPJEN E THIRRJES PËR TË NJËJTËN TEMË PROJEKTI SHKENCOR "65 VJET TRASHËGIMI E HISTORI E UST NË LENTEN E KËRKUESVE DHE STUDIUESVE MULTIDISCIPLINARË"

Mbështetur në nenin 3, 38, 95 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, v.k.m-në nr. 57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e Statusit të Veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës, në nenin 7, 20, 83 të Statutit të UST-së, në nenin 11 të Rregullores së UST-së, mbështetur në vendimin e Bordit të Administrimit nr.57, datë 07.08.2023 “Për pezullimin e pjesshëm të zbatimit të vendimit të Bordit të Administrimit nr.31, datë 30.06.2022 “Për miratimin e financimit të Projekteve Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Relacionit nr. 2354 prot., datë 26.09.2023 të Grupit të Punës për rivlerësimin e veprimtarive dhe të efekteve financiare të projektit kërkimor shkencor “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST-së në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.10.2023,

V E N D O S I :

1. Mbylljen e Projektit fitues me Vendim nr.10 datë 28.06.2022 të Komisionit të Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore me temë “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”; në përputhje me Vendimin nr.57, datë 07.08.2023 “Për pezullimin e pjesshëm të zbatimit të Vendimit të Bordit të Administrimit nr.31, datë 30.06.2022 “Për miratimin e financimit të Projekteve Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, të Bordit të Administrimit të UST-së.
2. Hapjen e thirrjes për të njëjtën temë Projekti shkencor “65 vjet trashëgimi dhe histori e UST në lanten e kërkuesve dhe studiuesve multidisiplinarë”, duke respektuar të gjitha standardet dhe rregullat për hapjen dhe menaxhimin e projekteve kërkimore shkencore, duke filluar me hartimin e objektivave të projektit, termave të referencës, mënyrën e vlerësimit për garantimin e cilësisë së produkteve të marra nga ky projekt, termat kohore të realizimit të produkteve si dhe garantimin e menaxhimit financiar, deri në evidentim dhe magazinim të realizimit të të gjithë projektit në tërësinë e tij.

3. Ngarkohet Komisioni i Kërkimit, Projekteve dhe Botimeve Shkencore.për hartimin dhe aplikimin e thirrjes si më lart.
4. Ky Vendim i përcillet për njohje Bordit të Administrimit dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Shërbimeve Akademiko Shkencore për publikim.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA

